



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:086383

Datë: 16.09.2024

Numri i dokumentit: 06164092

KPPP.nr. 506/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përmbartimore të kreditorit Metal Laçi SH.P.K., me numër unik identifikues 811182451 dhe me seli në Ferizaj, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Admir Salihu, avokat nga Ferizaj, kundër debitorit Royal A Sh.P.K., me numër unik identifikues 600768016 dhe seli në Prishtinë, rr. "Mati 1", duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr. 128/24 të datës 23.02.2024, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Sheremet Livoreka me seli të zyrës në Ferizaj, jashtë seancës, me datë 16.09.2024 merr këtë.

A K T V E N D I M

- I. PRANOHET pjesërisht prapësimi i debitorit Royal A Sh.P.K., seli në Prishtinë ashtu që ANULOHET pjesërisht Urdhri Përmbartimor P.nr. 128/24 i datës 23.02.2024, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Sheremet Livoreka, sa i përket detyrimit në shumë prej 1,034.00 EUR.
- II. REFUZOHET pjesërisht prapësimi i debitorit Royal A Sh.P.K., seli në Prishtinë ashtu që MBETET NË FUQI pjesërisht Urdhri Përmbartimor P.nr. 128/24 i datës 23.02.2024, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Sheremet Livoreka sa i përket detyrimit prej 3,720.00 EUR.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Metal Laçi SH.P.K., me datë 23.02.2024 ka lëshuar Urdhrit Përmbartimor P.nr. 128/24 me të cilin ka lejuar përmbartimin, në bazë të dokumenteve: Faturës nr. 14/23, e datës 29.03.2023 dhe Faturës nr. 13/23, e datës 29.03.2023, duke urdhëruar debitorin që në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit të urdhrit t'i paguaj kreditorit borxhin nga faturat e lartcekura në shumë prej 4,754.00 EUR € (katërmijë e

shtatëqind e pesëdhjetë e katër euro), me kamatë ligjore prej 8%, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore dhe shpenzimet për përpilimin e propozimit për përmbartim në shumë prej 156.00 EUR.

Debitori, brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim duke kontestuar urdhrin për përmbartim me arsyetimin se urdhri për përmbartim është lejuar në bazë të faturave të cilat janë në kundërshtim me nenin 29, par. 1, pika 1.3 të LPP-së, duke mos qenë të përshtatshme për përmbartim. Më tej, ka theksuar se një pjesë e faturave është paguar përmes transferit bankar, ndërsa për pjesën tjetër ende nuk kanë arritur në raporte të barazimit zyrtar duke qenë se faturat janë të pa nënshkruara dhe vulosura. Për këto arsye, i ka propozuar gjykatës që të aprovojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhri përmbartimor të anulohet.

Kreditori, në përgjigje në prapësim ka kundërshtuar në tërësi prapësimin e debitorit për faktin se qëllimi i debitorit është shtyrja dhe prolongimi i përmbushjes së detyrimit ndaj kreditorit, duke qenë se i njëjti ka paguar një pjesë të shumës sipas faturës nr. 14/23 të datës 29.03.2023 përmes transferit bankar. I ka propozuar gjykatës që të refuzojë prapësimin e debitorit si të pa bazuar, si dhe të obligohet debitori që të kompensojë shpenzimet e procedurës për përpilimin e përgjigjes në prapësim në shumë prej 312.00 EUR.

Gjykata, pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe deklarimeve të kreditorit në përgjigje ndaj prapësimin, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pjesërisht i bazuar për shkaket si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me nën-par.1.3 të këtij neni fatura përcaktohet si një nga dokumentet e besueshme, kurse me nenin 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, dhe me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*.

Në mbështetje të dispozitave të cekura si më lartë, gjykata vendosi si në pikën I të këtij Aktvendimi duke anuluar pjesërisht urdhrin përmbartimor për borxhin në lartësi prej 1,034.00

EUR sipas Faturës nr. 13/23 e datës 29.03.2023 ngase kjo faturë, nuk përmban nënshkrimin apo vulën e debitorit tek pranuesi i faturës, ndërsa kreditori nuk ka dëshmuar se të njëjtën faturë i'a ka dorëzuar në ndonjë mënyrë tjetër të përshtatshme debitorit, në mënyrë që ky i fundit të njoftohet për detyrimin që buron nga kjo faturë.

Andaj, fatura si e tillë rezulton të jenë lëshuar në mënyrë të njëanshme nga ana e kreditorit dhe rrjedhimisht nuk është e përshtatshme për përmbarrim.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi, duke lënë në fuqi urdhrin përmbarrimor për pjesën e detyrimit në lartësi prej EUR 3,720.00, ngase lidhur me këtë pjesë të detyrimit, dokumenti i besueshëm përkatësisht Fatura nr. 14/23 e datës 29.03.2023, i përmban të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm siç kërkohet me nenin 29, paragrafi 3 të LPP-së, për arsye se në të njëjtën faturë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, është emërtuar qartë objekti i faturës, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Në anën tjetër, përkundër që fatura e lartcekur nuk përmban nënshkrimin apo vulën e debitorit, nga transferi bankar i datës 21.01.2023 i ofruar nga vet debitori si dëshmi me rastin e paraqitjes së prapësimin, rezulton se i njëjti ka parapaguar për pro-faturën nr. 15/23 në vlerë prej 3,270.00 EUR, e cila pro faturë nuk ishte kontestuese mes palëve ndërgjyqëse se është shndërruar në faturë dhe ka marrë numrin nr. 14/23. Andaj, meqenëse për palën debitore nuk është kontestues fakti se i njëjti ka pranuar faturën e lartcekur dhe të njëjtën e ka paguar pjesërisht, gjykata erdhi në përfundim se fatura në fjalë është e përshtatshme për përmbarrim dhe paraqet bazë për lejimin e përmbarrimit.

Gjykata ka vlerësuar pretendimet tjera të debitorit të paraqitura në prapësim, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk paraqesin bazë për anulimin e tërësishëm të urdhrin përmbarrimor në kuptim të nenit 71 të LPP-së, ndërsa në mbështetje të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga sa më sipër, bazuar në nenin 73, paragrafi 3 të LPP-së, nenin 13, paragrafi 1, pika 1.2, dhe Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 506/24, datë 16.09.2024

Numri i lëndës: 2024:086383  
Datë: 16.09.2024  
Numri i dokumentit: 06164092

Gjyqtari  
Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE. Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.